



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 prill 2024 (e enjte) me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 mars 2024;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë 2024-2026;
4. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 75/24  
Nr. i fq. / Br. st - 1 -  
Data: / Datum 15.04.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

<b>PËR:</b>	Kuvendin e komunës
<b>NGA:</b>	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
<b>PËRMES:</b>	Sekretarisë së Kuvendit
<b>TEMA:</b>	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.04.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 prill 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

- Shqyrtimi i Raportit tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
- Shqyrtimi i Draft – Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë 2024-2026.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -III- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 MARS 2024**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Ali Januzi, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fatmire Cecelia, Fakete Dushi, Jeton Gjaka, Mek Selaci, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehulli dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Agron Përçuku, Gresa Muli dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 32 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit**-në fillim të mbledhjes prezantoi para kuvendit pikat e dërguara për rendin e ditës në të ndryshme.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-në adresimin e saj para kuvendit ngriti disa çështje, që lidhen me aktivitetet e kryetarit të komunës siç janë: takimet e kryetarit të komunës me disa ministra të Qeverisë së Kosovës, ku shpreson se këto takime do të jenë frytdhënës për qytetarët e komunës sonë. Më pas pyeti rreth problemit me qentë endacak pas që kjo problematik është rritur shumë dhe ka shumë qytetarë që janë sulmuar nga qenët endacak, kjo problematikë duhet të adresohet me nivelin qendror për gjetur një zgjidhje. Lidhur me takimet e kryetarit të komunës me ministrat e dikastereve të ndryshme ato janë takime thjesht sa për ta thyer montonin e rrjeteve sociale, nga proklamimet e përsëritura si pastrimi i proçkave, lulet dhe rrethi i flamurit por nuk ka diçka zhvillimore për komunën. Ajo çka dëshirojnë të dinë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë është se çfarë ka bërë kryetari i komunës për këto dy vitet qeverisëse, dhe këtu numërojmë dy projektet të mëdha me kosto super të lartë si parkingu nëntokësor dhe tregu i perimeve në Vushtri. Lidhur me këto dy projektet pyeti se sa është e nevojshme që në një afërsi të shkurtër të kemi dy

parkingje nëntokësore kaq afër njëra tjetrës. Ajo çfarë është e rëndësishme është fakti se parkingu nëntokësor tek tregu është afër Lumit “Tërstena” dhe ka mundësi që ai kur kemi të reshura të mëdha të vërshohet andaj duhet të izolohet mirë, por kjo sigurisht se ka një kosto të lartë. Kur llogaritim kost-benefitin, del se përfitimet janë shumë më të vogla se sa kostoja investive e këtyre dy projekteve andaj këtu duhet shikuar se a ka interesa tjera të ngushta. Në fund ngriti çështje e kundërmimit të erës afër tregut aktual, dhe pyet se çfarë masash janë ndërmarrë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-pasi i uroj të gjithë muajin e shenjtë të ramazanit i përshëndeti gjithë të pranishmit që prezantojnë në seancën e kuvendit, më tej shtoj se para disa mbledhjeve kishte propozuar që shtesat për fëmijët e porsalindur të rriten nga 120 në 250 €, ky qëndrim ishte aprovuar nga asamblistët, por votat e numëruar gabimisht kishte bërë që ky vendim të anulohet, në mënyrë të padrejtë. Në anë tjetër qeveria dhe kryetari i komunës u zotua se do ta sillte para kuvendit një analizë financiare për gjendjen e subvencione por një gjë e tillë nuk po ndodhë. Pra nuk kishte të bënte me përmbushjen e këtij vullneti por thjesht kundërshtimi i propozimit për rritjen e këtyre shtesave për fëmijët e porsalindur. Pastaj shërbyesve civil të Komunës së Vushtrrisë iu është bërë një lajthitje me votimin për pagesën e shujtës, andaj pyeti se çfarë po ndodh me vendimin për shujta e punëtorëve komunal. Ftoj kryetarin e komunës që këtyre punëtorëve të iu thotë të vërteten, ndërsa kërkoj nga kryesuesja e kuvendit të jap sqarime se ku ka mbetur çështja e këtij vendimi, sepse në vend që në MAPL të dërgohet së paku njëri vendim për filtrim të ligjshmërisë atje në mënyrë skandaloze kërkohet sqarime se çfarë duhet bërë thua që MAPL duhet të marr vendim në vend të anëtarëve të kuvendit, pra ndodhemi si komunë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe. Kësaj qeveri sikur nuk i mjaftoj por hapi edhe një gropë në mes të qytetit dhe i mbylli ato biznese duke mos ju ofruar kurrfarë ndihem. Lidhur me këto vendim që janë marr për projektet si sheshi dhe parkingu nëntokësor, a është dashur të mbahet një diskutim publik, një seancë e jashtëzakonshme më të marr një opinion më të gjerë për këto projekte milionëshe. Në fund i bëri thirrje kryetari të komunës që zbatoj vendimet e kuvendit për shtesat e fëmijëve dhe shujtat e shërbyesve civil, të gjej zgjidhje për ofrimin e ndihmës për bizneset në sheshin e qytetit, dhe këto duke mos shikuar dallimet dhe përkatësit partiake e politike.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-pyeti sa a duhet marr fjalën qytetaret pronarë të bizneseve tek stacioni i vjetër i autobusëve në rr.”Avni Saraçi” të cilëve para disa ditëve iu është dërguar një shkresë-njoftim për lirimin e atyre lokaleve, për këtë pyeti se përse duhet ti lirojnë këto lokale, dhe çka është paraparë të ndërtohet në atë vend lokalitet, kjo për faktin se këto familje burim kryesor e kanë këto biznese. Propozoj që këtyre bizneseve të iu mundësohet të vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre në ato lokale.

**Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit**-sqaroi se nga MAPL, ka kërkuar të sqaroj lidhur me çështjen e shujtave të shërbyesve civil, sepse ka pasur nevojë ti marr ato sqarime, dhe për këtë ajo deri sa të sqarohet krejtësisht kjo çështje nuk do të nënshkruaj një vendim të tillë.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-paraqiti sqarime hyrëse duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit dhe shtoj se vizitat e tij në cilësinë e kryetarit të komunës janë në saj të bashkëpunimit mes institucioneve lokale dhe atyre qendrore që janë obligim ligjor dhe kushtetues, por është edhe një frymë e bashkëpunimit reciprok, dhe në të gjitha këto takim janë diskutuar tema në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë si: rregullimi i stadiumit të futbollit, restaurimi i urës së gurit, për hamamin e qytetit, është biseduar për objektin e gjykatës i cili është në një gjendje jashtëzakonisht të keqe dhe po i rrezikon qytetaret e Komunës së Vushtrrisë por edhe është bërë një vend i dukurive negative. Më tej është diskutuar për një pronë të ish Motel “Vicanumit” e cila do të mund të shfrytëzohej për nevojat e Komunës së Vushtrrisë për ndërtimin e stacionit të autobusëve për ndërtim të ndonjë çerdheje për fëmijët ose ndonjë projekt tjetër kapital. Më pas me

ministrin e Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë, është biseduar për zonën ekonomike në Lumadh që është investim i tyre, që në këtë proces ka pasur mjaft shumë të gjetura nga disa institucion, që e kanë shtyrë këtë proces për të cilin nuk kishte dashur të ndodh një gjë e tillë. Lidhur me këtë çështje duhet të shikohet mundësia që gjendet një zgjidhje ashtu që bizneset serioze të zhvillojnë kapitalin e tyre dhe aktivitetin në favor të zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-tha se duke marr për bazë të arriturat e sportistëve tanë që kanë bërë krenar me punën e tyre Qytetin e Vushtrrisë, duke ngritur lartë majat e sukseseve të tyre që kanë bërë që ngritët prestigji dhe reputacioni i qytetit tanë, duke u bazuar në rregulloren për Dekorata të Komunës së Vushtrrisë propozoi që të ndahet çmimi krenari e sportit për z. Bujar Muli për sukseset në sportet ekstreme në peshëmbajtje. Ky sportist përpos që nuk u mbështet financiarisht ai nuk u ftua as në ngjarjet kryesore sportive të organizuara nga Komuna e Vushtrrisë konkretisht DKRS-ja, kjo tregon më së miri se sa është duke i përkrahur komuna sportistët tanë. Sportisti vushtrrias Eron Kasumi i cili ka sjell medaljen e bronzit në sportin e boksit, po ashtu meriton përkrahje nga komuna, sportist ky që renditet me nivelet e sportistëve si Nora Gjakova e Distrie Krasniqi. Andaj propozoi që të futet në rendin e ditës mbështetja financiare për këtë dy sportist, sipas rregullores për dekorata.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-në mbështetje të rregullores për punën e kuvendit, propozoi që të futet në rendin e ditës për shqyrtim propozim-vendimi për funksionalizimin e Zonës Ekonomike-Parku Industrial në fshatin Lumadh.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se bazuar në planin e kuvendit në këtë mbledhje është dashur të shqyrtohet raporti i punës i N.P.L. "Përparimi" i cili në është ofruar nga kjo ndërmarrje nën arsyetimin se është duke audituar nga auditori gjeneral. Në asnjë rast nuk është e përcaktuar se ky raport duhet të shqyrtohet pas auditimit. Në vitin 2023 kjo kompani ka sjellë një raport tepër skandaloz për vitin 2022, e që edhe tani raporti nuk dërgohet para kuvendit dhe kjo është edhe një element shtesë se menaxhmenti i kësaj ndërmarrje nuk është në krye të detyrës. Lidhur me propozimin e anëtarit të kuvendit z.Bekim Zabërgja deklaroi se e kundërshtoj në tërësi, sepse ajo çështje është kthyer në piken zero nga po ky kuvend dhe çështja është dërguar për hetim në organet e drejtësisë, andaj deri në një epilog gjyqësor duhet të presim që të mos interferojmë në punën e këtyre organeve. Lidhur me këtë çështje ai shpreh keqardhje se si kryetari dhe nënkryetari i komunës, përdorin deputet të pakicës për të propozuar çështje të caktuara atëherë kur dëshirojnë të shtyjnë përpara agjenda të caktuara.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-tha se ai nuk është kundër zonës ekonomike, por është kundër procesit që ka ndodhur dhe keq menaxhimi që e ka përcjellë këtë proces. Tutje shtoi se ai propozoi që procedohet kjo çështje në bazë të ndryshimeve që kanë ndodhur, sepse ka ndryshime të mëdha në Ligjin për Zonat Ekonomike. Ndër të tjera ceku se ajo zonë është financuar nga MTI-ja, në kohën kur ai ka qenë këshilltar në këtë ministri dhe i kishte dhënë një shtytje të madhe realizimit të këtij projekti, andaj nëse ky akuzohet për këtë çështje kjo është më tepër se hipokrizi.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se parafolës ka qenë kryesues i komisionit hetimor, për çështjen e parkut industrial, dhe raportin që e ka sjellë ky komision e kishin mbështetur gjithë deputetët, por tani nuk duhet marr ndonjë vendim pa u zbardhur kjo çështje nga organet e drejtësisë.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-lidhur me mbështetjen e sportistëve, ceku se asnjëherë nuk është mjaft, por këto vitet sportistët janë mbështetur më së shumtë krahasuar me mandatet e kaluara dhe kjo mund të dëshmohet me raporte dhe me statistika. Ai shtoi se do të mbështet të gjithë sportistët pa dallim, ku ceku se për çmimet si krenaria e sportit dhe të tjerë vendos kuvendi në saj të propozimit që e sjell kryetari i komunës tek komisioni e më tej propozohet në kuvend për aprovim.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-tha se e kundërshton në tërësi propozimin që të futet në rendin e ditës çështja për funksionalizimin e Zonës Ekonomike, kjo për faktin se duhet të analizohet mirë kjo çështje e më pas të bëhen ndryshimet e duhura dhe më pas të sillen në kuvend për aprovim. Më pas vlerësoi se të gjithë e dimë se në këtë proces ka pasur shkelejt të mëdha dhe ato duhet adresuar dhe duhet marr një përfundim gjyqësor më pas duhet konform arsyetimit dhe ndryshimeve duhet të sillen në kuvend për aprovim. Propozoi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se para se të merren vendime ato duhet të analizohen si nga aspekti ligjor ashtu edhe nga aspekti financiar, dhe kërkoj nga Drejtoresha për Kulturë të jap sqarime si është e rregulluar çështja e çmimeve si krenaria e sportit dhe çmimet tjera. Lidhur me propozimin për zonën ekonomike në Lumadh njoftoj se kallëzimi penal lidhur me këtë çështje është hedhur poshtë dhe tani nuk ka kurrfarë pengesa që kjo çështje të procedohet për aprovim dhe votim.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-lidhur me çështjen e zonës ekonomike, ceku se ka zëra se kallëzimi penal është hedhur poshtë, nëse në gjë e tillë ka ndodhur atëherë ai vendim duhet të iu dërgohet anëtarëve të kuvendit, nëse është hedhur poshtë atëherë ekziston parimi i dy shkallësisë, a është atakuar ky vendim nga kryetari i komunës. Për këtë çështje kemi pasur një vendim edhe nga MAPL dhe Agjencia Kundër Korrupsion ku është konstatuar shkelje procedurale dhe konflikt i interesit në këtë çështje, por janë edhe të gjetura tjera të komisionit që janë të faktura.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i procedoj për votim në mënyrë individuale pika e dërguar në të ndryshme dhe atë si vijon:

Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë të shtëpisë së Kahriman Pasomës;

Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë së Selatin Gërxfaliut, pronë e Nexhmedin Gërxfaliut;

Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim – vendimit **për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me formimin e KKSB-së;**

**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së**-paraqiti sqarime lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim ku ceku se kemi të bëjmë me disa kioska dhe me disa parcela për të cilat ka shprehje të interesit për ti marr në shfrytëzim ato prona për aktivitet e biznesit të tyre.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se dhënia e pronës në shfrytëzime është ndër proceset më të rëndësishme që ka në kompetencë kuvendi i komunës, dhe këto materiale kanë ardhur tepër vonë pa u analizuar dhe të njëjtat nuk janë shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa e që kjo përbën shkelje procedurale, propozoi që këto propozime të shtyhen për mbledhjen e radhës.

Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” 7 vota “abstenim” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;

Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 7 vota “abstenim” e aprovoj për inkomporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;

Kuvendi pas votimit me 16 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim e aprovoj për inkomporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për funksionalizimin e Zonës Ekonomik-Parku Industrial në Lumadh;

Kuvendi pas votimit me 12 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim nuk e aprovoj për inkomporim në rendin e ditës Propozim – vendimit për ndarjen çmimit “Krenaria e Sportit” i bërë nga anëtarja e kuvendit Fatmire Cecelia, ndërsa propozimi i kryetarit të komunës që ky propozim të votohet në datat e çlirimit të qytetit të Vushtrrisë i mori 15 vota “për” dhe kryesuesja e kuvendit e konstatoj si propozim të aprovuar.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 4 vota “kundër” aprovoi këtë:**

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shkurt 2024, vazhduar më datën 07 mars 2024;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 05 mars 2024;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023;
6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat;
7. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i peticionit të banorëve që shtrihen përgjatë rrugës “Avni Saraçi”;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë së Kahriman Pasomës;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë së Selatin Gërxhaliut, pronë e Nexhmedin Gërxhaliut;
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me formimin e KKSB-së;
13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
14. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
15. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për funksionalizimin e Zonës Ekonomik-Parku Industrial në Lumadh;
16. Pyetje dhe përgjigje

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shkurt 2024, vazhduar më datën 07 mars 2024;

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-kërkoi nga Sekretaria e Kuvendit, që pikën e 9 të rendit të ditës ta konkludoj dhe ndryshoj sipas konstatimeve që ka dhëna kryesuesja e kuvendit në mbledhjen e mbajtur më datë 29 shkurt 2024, vazhduar më datën 07 mars 2024, në bazë të incizimeve nga ajo seancë.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 18 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shkurt 2024, vazhduar më datën 07 mars 2024, me vërejtjen-sqarimin e dhënë nga kryesuesja e kuvendit.**

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 05 mars 2024;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 20 vota “për”, 1 votë “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 05 mars 2024.**

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**- lidhur me raportin për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023, vlerësoi se në raport thuhet se realizmi i shpenzimeve të gjitha fondeve është 95%, për këtë është mirë të iu thuhet e vërteta qytetarëve sepse realizmi është 95% por jo edhe realizimi i projekteve kapitale, sepse kjo përqindje në shpenzim të buxhetit ka ardhur si rezultat i vendimeve gjyqësore, për obligimet që ka pasur komuna ndaj punëtorëve të arsimit që kanë buruar nga kontrata kolektive, pra shpenzuesit më të mëdhenj janë përmbaruesit privat të cilët në fund të vitit 2023 i morën borxhe komunës së Vushtrrisë mbi 3 milion euro dhe si pasojë e kësaj shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar. Tutje shtoj se në raport janë specifikuar projektet e realizuar, por i rikujtoj kryetarit të komunës se pas 3 viteve qeverisje akoma qytetarët nuk kanë ujë të pijes, edhe pse premtimi i kryetarit ka qenë se përfundimi i procesit për furnizim do të bëhet qysh në vitin e parë. Në faqen 36 duhet të korrigjohet një gabim teknik lidhur me numrin e kryetarëve të këshillave lokal. Në faqe 20 tek shërbimet publike thuhet se janë investuar 261.000.00€ për rrugë me kubëza betoni ku janë shtruar 2436 m<sup>2</sup> dhe nëse llogarisim çmimi për metër katrorë del një çmim enormë i larët afër 105 € për metër katrorë dhe si tillë ky raport nuk meriton të përkrahet. Ajo çka e karakterizoj arsimin në vitin 2023 është dorëheqja e Dardan Abazit nga Drejtoria e Arsimit dhe emërimi i Albanëz Tahirajt në pozitën e drejtorit të DKA-së i cili në karrierën e tij nuk ka mbajtur asnjë orë mësimi, zgjedhja e drejtorëve politikë nëpër shkolla pra politizimi i skajshëm i arsimit, ku si pasojë e kësaj kemi rënie të cilësisë në këtë fushë, anulimi i konkurseve për pranimin e mësimdhënësve, ka bërë që të kemi humbej të shumë orëve mësimor nëpër shkollat e ndryshme të komunës. Shumë shkolla kanë pasur mungesë të materialeve shpenzuese si letër, toner dhe lëndë djegëse për ngrohej. Në faqe 23 të raportit evidentohet se kemi numër të vogël të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm, kurse numri me i nxënësve me sukses të mjaftueshëm është i madh që është indikator i rëndësishëm për gjendjen në arsim. Tek klasë e X



dhe XI të shkollës së mesme tek nxënësit që e përsërisin vitin me tri nota të dobëta ku evidentohet se nxënësit me tri e më shumë nota të dobëta janë 32 nxënës, ndërsa tek rubrika nxënësit që e përsërisin vitin janë evidentuar me shifrën 11 nxënës kjo duhet të saktësohet dhe të korrigjohet. Po ashtu tek klasët e XI thuhet se nxënës me tri nota të dobëta janë 12, ndërsa tek rubrika kemi zero. Në fund tha se duke i parë të gjitha këtë lëshim në këtë raport, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës të korrigjohet e më pas të sillet për aprovim.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se për investimet kapitale në vitin 2023 është dashur të bëhet një prerje në pagesat e kësteve të obligimeve për kontratorët, me qëllim të mbulimit të obligimeve financiare për mësimdhënësit që dalin nga kontrata kolektive. Tani kemi kontrata por këto kanë qenë të lidhura në vitin 2023 si sheshi i qytetit, tregu i qytetit, shkolla “Mustafë Venahari” ndërtimi i rrugës “Avni Saraçi”, rr.”Bekim Berisha”, rr. “Lumni Surdulli” d.m.th kemi shumë investime që asnjëherë më parë nuk ka ndodhur. Sa i përket këshillave të fshatrave ai e falënderoj komisionin për punën që kanë bërë, por parafolësi është dashur ta përmend se kryetari nuk ka interferuar politikisht në zgjedhjen e këtyre fshatrave por i ka përkrahur në plotni komision dhe themelimin e këtyre këshillave.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vlerësoi se ky raport është dashur të jetë pika më debutuese në këtë kuvend duke vënë në theks se a janë realizuar të gjitha mjetet e planifikuar në buxhet për investime kapitale dhe e ka pasur kjo inpakt në zhvillimin ekonomik këto shpenzime në këto projekte, por lidhur këto çështje asgjë nuk është evidentuar në këtë raport. Viti 2023 realisht ka qenë vit i dështimit të madh në aspektin e zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, ku pothuajse i gjithë buxheti i komunës ka përfunduar tek avokat dhe përmbauesit privat por jo në realizimin e projekteve dhe kështu komuna e ka humbur mundësinë për zhvillimin e projekteve që janë të adresuar në përmasimin e jetës për qytetarët tanë. Kur flasim për raportin për zhvillimin ekonomik kryetari i komunës duhet të ia bëjë disa pyetje vetës: gjatë vitit 2023 a ndryshoj gjendja e furnizimit me ujë të pijes për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, cila është gjendja e kanalizimeve p.sh në fshatin Akrashticë është lidhur kontrata dyvjeçare për kanalizimin dhe vetëm shkoni dhe shikon se ku përfundon kolektori kryesor i fshatit, kur ujërat e zeza përfundojnë në hapësirë publike dhe kjo është në kundërshtim me standardet minimale të shëndetësisë, ku ka rrezik për përhapje të epidemisë. Pastaj kemi dështim të madh në fushën e bujqësisë ku nga 800,000.00 € investime në mjetet bujqësore në mandatin e kaluar në vitin 2023 kemi vetëm 160,000.00€ dhe kjo nuk do kurrfarë komenti. Më pas ai pyeti drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë se në vitin 2023 cilat mjetet bujqësore i kanë përfituar qytetarët nga buxheti i komunës, sepse nuk ka pasur asnjë investim. Pastaj ceku se si subjekt i gëzohet çdo subvencionim si për qumështin për delet për gjitha të tjerat, por bilanci përfundimtar i investimeve për vitin 2023 është 160.000.00 € që është bilanc rekord i varfër. Në fund shtroj se krejt e dimë se cila është gjendja në arsim të gjithë e dimë, ku kemi pasur anulime të konkurseve, punësime partiake, politizim të arsimit dhe kjo ka bërë që arsim në rrënohet në Komunën e Vushtrrisë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-tha se ky raport më tepër i ngjan raporti të drejtorive komunale, dhe ceku se mungon raporti i punës i Teatrit të Qytetit “Adem Mikullofci”, dhe pyeti se ka bërë ekzekutivi komunal analizë financiare për sa i përket këtij teatri. Në vitin e kaluar është mbajtur një festival nga ana e këtij teatri ku nga 2000 € sa janë planifikuar, për këtë festival ka kushtuar një drek në shuma marramendëse dhe këtu po shihet qartë se ka pasur keqpërdorim të parashë publike. Në sektorin e rinisë është planifikuar një grantë i quajtur komuna për rinin, CDEF-i , por që më vonë u anulua për shkak të padrejtësive. Gjatë ditës se djeshme është rishpall ky grantë ndërsa në raport evidentohet se ky projekt është zbatuar. Në fund pyeti drejtoreshën për Kulturë se mbi bazën e çfarë procedurave është licencuar Qendra e Rinis në Vushtrri.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se ka mangësi në kontratat e përgjithshme të zhvillimit edhe përkundër punës mjaft të madhe, dinamike dhe voluminoze. A ceku se ka pasur mjaft shumë investime në bujqësi dhe ftoj drejtorin e këtij dikasteri të sjell para kuvendit një informatë me statistika të investimeve në bujqësi. Tutje shtoj se arsyeja se përse është aplikuar kjo formë e investimeve në bujqësi është për faktin se në të kaluarën është përfolur se ka pasur shumë nepotizëm në ndarjen e mjeteve bujqësore, ku ka indicje se mjetet bujqësore i kanë marr njerëzit që kanë jetuar nëpër banesa dhe të njëjtat i kanë shitur, dhe për të ikur kësaj është zbatuar politika e subvencionimit të qumështit dhe në këtë proces nuk ka pasur asnjë ankesë sepse kanë përfituar të gjithë ata që mbajnë lopë, mandej janë subvencionuar tokat nën ujtitje me 50% dhe edhe ky proces ka qenë krejtësisht transparentë dhe përfitimet kanë qenë në adresën e duhur. Pastaj janë subvencionuar delet, dhitë, bletët dhe janë subvencionuar edhe bollicat si një specie në zhdukje, janë ndarë 276 sera me sipërfaqe nga 1ari dhe edhe ky është një investim. Në fund tha se nuk është i kënaqur por krahasuar me vitet e kaluara investimet në bujqësi janë rritur pa krahasimishtë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se me që kemi pretendime nga ana e kryetarit të komunës se ka pasur shumë investime në bujqësi, atëherë ai kërkoj të kemi një informatë për buxhetin dhe investimet në bujqësi për vitet 2019-2020-2021 dhe të krahasohen ato me vitet 2022-2023 dhe 2024 në qeverisjen aktuale. Po ashtu kërkoj nga kryesuesja e kuvendit të zbatoj rregulloren e punës, duke i përjashtuar nga mbledhja ata diskutues që fyejnë dhe ofendojnë në sallën e mbledhjes.

**Medina Bunjaku, drejtoresh e DKRS-së**- njoftoi se festivale i teatrit të qytetit, është financuar nga ministria dhe DKRS-ja, ministria ka financuar anë organizative, ndërsa komuna ka mbuluar shpenzimet për dy darka, dhe nëse ka shkelje atëherë le të veprojnë organet kompetente.

**Ergyn Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së**-paraqiti sqarime duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Lidhur me investimet sqaroi se në vitin 2021 buxheti i bujqësisë ka qenë 145,000.00 € dhe qeveria në vijueshmërinë e saj ka përmbushur obligimet e mbetura. Në vitin 2022 buxheti është rritur në 200,000.00 € dhe do të shkohet duke u rritur ky buxhet.

#### 4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se ajo çka është e rëndësishme dhe që duhet të merremi shumë seriozisht është shkollat me numër të vogël të nxënësve, ku kemi 9 shkolla me numër jashtëzakonisht të vogël e që duhet të bëjmë një zgjidhje. Mesatarja e nxënësve nëpër klasë në këto klasë është 3.4 nxënës. Kjo është tepër problematike sepse kjo bën që të bie motivi tek arsimtaret për mësim edhe tek nxënësit po ashtu dhe kjo ndikon direkt në kualitetin procesit mësimor dhe në mësimnxënie.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar faqes 3 të kësaj informate thuhet se fillimi i vitit shkollor 2023-2024 u ballafaqua me një pengesë të papritur për shkak të ndryshimit të papritur të politikës së subvencionimit të librave nga Ministria e Arsimit. Ai konsideron se kjo politikë nuk ishte pengesë por përmes saj u arrit që buxhetit të shtetit iu kursyen mijëra euro të cilat më parë ishin keqpërdorur përmes tenderëve për blerjen e librave nga qeveritë e kaluara, dhe se furnizimi me libra është bërë me kohë pa asnjë vonesë dhe nuk ka shkaktuar asnjë vonesë në fillimin e zbatimit të kurrikulës në shkollat e komunës sonë. Tutje mendon se ndërrimi i shpeshtë i drejtorëve të arsimit në komunën tonë është pengesa kryesore në zhvillimin e arsimit, sepse nga fundit i vitit 2021 e deri në vitin 2023 kemi pasur tre drejtor të arsimit dhe vetëm njëri prej tyre ishte nga fusha e arsimit. Duke mos qenë nga kjo fushë është pak e pritshme nga ta që ti qojnë proceset përpara dhe të kemi zhvillim të qëndrueshëm të arsimit në komunën tonë. Është

shqetësuese trendi i zvogëlimit të numrit të nxënësve nëpër shkollat tona, sepse në bazë të raporteve të prezantuara në fund të vitit shkollor 2022-2023 kemi pasur 13,151 nxënës, ndërsa në fund të gjysëmvetorit të vitit shkollor 2023-2024 kemi 12,297 nxënës, apo 854 nxënës më pak, për këtë ai mendon se kjo informatë është e gabuar sepse nuk ka mundësi që për një periudhë më pak se gjashtë muaj të bie kaq shumë numri i nxënësve dhe kjo e bënë të dyshimtë këtë informatë. Po ashtu shqetësuese është edhe rënia e suksesit dhe numri i madh i mungesave, prandaj e pyeti Drejtorin e Arsimit se cilat masa i ka ndërmarrë që të përmirësohet sukcesi i nxënësve gjatë vitit 2024.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-tha se problemi me shkollat me numër të vogël të nxënësve është problem në gjithë Republikën e Kosovës, dhe kjo është e shprehur sidomos në rajonet rurale ku kemi migrim të popullatës në drejt qytetit. Do të kishte qenë mirë të gjendet një zgjidhje për këtë çështje, por është një problem bukur i madh ku nuk po ka guxim nga askush që të fillohet ky proces dhe të gjendet një zgjidhje. Ideja më e mirë kishte me qenë që të gjendet një konsensus mes mësimdhënësve, prindërve, komunës dhe komunitetit lokal për ato shkolla ashtu që të amortizohen kontestet dhe pakënaqësitë eventuale. Kjo çështje është bukur komplekse dhe bartë me veti edhe pasoja sepse len pa punë një numër të konsideruar të mësimdhënësve dhe ka efekte tjera të pa dëshirueshme.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se kjo informatë është shumë didaktike dhe e përgjithshme, andaj sugjeron që për të ardhmen të kemi një tjetër format të informatës ku do të përfshihen edhe shumë aktivitet tjera të mira që kryhen nga shkollat e komunës sonë. Në informatë do të duhej të evidentohet nga një fjali ose paragraf për gjendjen e secilës shkollë. Tutje shtoj se shkollat me numër të vogël të nxënësve vërtet është sfiduese, dhe për këtë duhet të kemi një konsensus politikë nëse dëshirojmë të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme. Pastaj kërkoj të jepen sqarime lidhur me lëndët dhe kuadrat deficitare të specifikohen ato. Të kemi prioritet dhe rritje të performancës sa i përket praktikave profesionale. Në informatë nuk kemi shifra dhe të dhëna të matshme për investimet kapitale dhe projektet e infrastrukturës në fushën e arsimit. Po ashtu flitet për mungesë të kabineteve dhe mjeteve didaktike, edhe pse kryetari i komunës ka pasur shumë premtime për sa i përket këtyre gjërave, andaj pyeti se çfarë është ndërmarr nga kryetari i komunës për ofrimin e këtyre kabineteve dhe mjeteve didaktike.

**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se disa nga rezultatet dhe aktivitetet në shkolla të ndryshme nuk janë të evidentuara në këtë informatë, në shkollën Gjinnazi “Eqrem Çabej” nuk janë evidentuar sukseste në garat e Fizikës, Matematikës dhe Biologjisë por edhe garat sportive. Po ashtu një nxënës e cila ka marr pjesë nga gara në Slloveni nuk është evidentuar në informatë. Në shkollën fillore në fshatin Oshlan mungojnë disa aktivitete. Pastaj një panair shkencorë i mbajtur nga nxënësit e shkollë Gjinnazi në Vushtrri nuk figuron në këtë informatë. Pastaj kërkoj sqarime nga ana ligjore se si funksionin kur kemi raste të dështimit të konkurseve me një kandidat. Në këtë kontekst shtoj se duhet të zbatohet Ligji për Arsimin Parauniversitar i cili jep mundësi ligjore për shmangien e anulimit të konkurseve në raste kur kemi mungesë të kandidatëve.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se vërtet është shqetësuese numri i vogël i nxënësve nëpër nëntë shkolla, por ky trend është në gjithë Republikën e Kosovës, ku gjithsejtë janë 240 shkolla që janë në këtë gjendje dhe dihet se një numër i tyre është vetëmbyll, për arsye të migrimëve brenda dhe jashtë vendit. Tutje sqaroi se nuk është në autoritetin e komunës që të themeloj dhe të mbyllë shkolla, sepse kjo kompetencë i takon Ministrisë së Arsimit, sepse për hapjen e një paralele apo një profili të ri duhet të merret aprovimi nga Ministria e Arsimit. Prandaj më që kjo bie në kompetencat e mistrysë, kjo duhet të marr përgjegjësit dhe të veprojnë në gjetjen e një zgjidhje më të mirë të mundshme. Pastaj kemi paralele që nuk janë kategori ligjore si p.sh kombinimi i paraleleve

ku mësimi në këto mbahet në mënyrë të jashtëligjshme sepse kjo nuk është e paraparë me ligj. Më tej në rastet e anulimit të konkurseve me vetëm një kandidat kjo është tepër problematike sepse kur kemi të bëjmë me kuadër deficitar atëherë mund të bëhen lajthitje. Nëse ministria e linjës bie vendim për fuzionimin e këtyre shkollave atëherë komuna është e obliguar të zbatoj në vendim të tillë, por jo në mënyrë arbitrare dhe të jashtëligjshme. Kohëve të fundit ka filluar mësimi dualë, ku disa nxënës drejtimi zduktari janë dërguar në një kompani që komuna e ka negociuar dhe ka lidhur kontratë për aftësimin e këtyre nxënësve dhe të njëjtit edhe do të marrin një pagë. Ne kemi problem me disa profile në shkollën profesionale p.sh ku do ta gjej veten një nxënës që e ka kryer shkollën e mesme drejtimi i ekonomisë, kur dihet se kemi kandidat të përgatitur në treg me nivel master. Pra këto çështje dhe probleme i ka adresuar në ministrinë e linjës, ku kemi menduar që të bëhet ndërrimi i profileve dhe të i përshtatim me nevojat e tregut të punës, pas aprovimit nga ana kësaj të fundit. më tej shtoj se ka pasur aktivitete të ndryshme dhe të njëjtat është dashur të futen në informatë. Në fund tha se për herë të parë është zbatuar politika stimuluese e motivimit të nxënësve dhe mësimdhënësve, duke ndarë shpërblime.

**Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-paraqiti** sqarime lidhur me informatën për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë të kuvendit në ç’ rast deklaroi: se është e vërtet që kemi problem me shkollat me numër të vogël të nxënësve por që kjo problematikë ekziston gati pothuajse që një dekadë, ndërsa anëtari i kuvend z.Maloku më mirë kishte me qenë të udhëheqte Drejtorinë e Arsimit se sa të merrej me kanalizimet e DSHP-së kur ai ka udhëhequr e ndoshta do ta riparonte gjendjen në arsim. Tani ky njëri nuk është i kënaqur me asgjë dhe ka indikacione se jeta opozitare i është shndërruar në depresion politik. Lidhur me subvencionimin e librave, ka pasur mjaft shumë problem deri sa është bërë furnizimi me libra shkollor. Ndërrimi i shpesh i drejtorëve të arsimit tashmë kjo temë është bërë demodë dhe nuk mund të jesh aktual duke e përsëritur të njëjtën sepse drejtori i arsimit jo domdoshmërisht duhet të jetë mësimdhënës sepse drejtori udhëheqë me pjesën menaxheriale të arsimit. Lidhur me masat e ndërmarra për përmirësimin e cilës së arsimit theksoj se drejtoritë komunale të arsimit zbatojnë politikat e ministrisë së linjës dhe këto ndikojnë direkt në përmirësimin ose jo të gjendjes në arsim. Pastaj konstatoj se ka mungesa të kualifikuarve në lëndët fizikë, kimi dhe muzikë, në drejtimin TIK ka të kualifikuar por që shumica orientohen në sektorin privat për shkak të pagesave më të mira, ndërsa në lëndën e matematikës kemi dy kandidatë në pritje. Pastaj ceku se DKA është hendikepuar me konkurset me tre të kualifikuar sepse ky kriter ligjor është tepër pengues në procedurat e suksesshme për rekrutim të stafit mësimor. Procesi i digjitalizimit të shkollave është duke shkuar mirë ku 12 shkolla janë në përfundim të këtij procesi. Lidhur me mos përfshirjen e disa aktiviteteve në këtë raport, vlerësoi se kjo informatë nuk është e karakterit regional e as racor për ta favorizuar dikë dhe për dëmtuar dikë tjetër. Në fund vlerësoi se kjo informatë është e prekshe dhe përmbajtsore dhe në aspektin e të dhënave dhe atë teknik është informatë e kompletuar.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-lidhur me konstatimin se nuk ka në pritej kandidat nga lënda e kimisë ceku se është Egzona Shyti master i kimisë që është e kualifikuar, dhe njoftoi se një vend i punës për këtë lëndë tinëzisht fshehët duke shpërndarë fondin e orëve me nga dy apo tri orë.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023;

6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Rregulloren për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.**

7. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovet Plani Lokal për Veprim për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2024-2026.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali si komunitete pakicë në Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Lokal për Veprim për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2024-2026.

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për varreza (groposjen e kafshëve) në pjesë të parcelës kadastrale P-70202027-00001-1, në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 664806 m<sup>2</sup>, kualiteti i klasës kullosë e KL. 5, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i petitionit të banorëve që shtrihen përgjatë rrugës “Avni Saraçi”;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024**, konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar petitionin e banorëve që banojnë përgjatë “Rr. Avni Saraçi”, të parashtruar në emër të z. Avdi Mehmeti, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve-shfrytëzuesve të objekteve aferistë për të iu vazhduar kontrata e dhënies në shfrytëzim të këtyre lokaleve, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, nxori këtë:

### **Rekomandim**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që shfrytëzuesve të lokaleve afariste që gjenden në Rr.”Avni Saraçi”, të iu mundësohet shfrytëzimi i atyre lokaleve afariste deri në përfundim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të atyre pronave, nga ana e Komunës së Vushtrrisë.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t’i informoj këta banorë shfrytëzues të këtyre lokaleve që janë parashtrues të petitionit, se të njëjti mund të konkurrojnë në procedurat për marrjen në shfrytëzim të këtyre lokaleve apo në ndonjë vend tjetre adekuat që do të shpallë Komuna e Vushtrrisë gjegjësisht Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për veprimin e ndërmarrë lidhur me këtë çështje, obligoheni të mbani të informuar banorët parashtrues të petitionit dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë së Kahriman Pasomës;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim shpallet me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” shtëpia e Kahriman Pasomes, pronë e Xhezair (Kahriman) Pasomes, e regjistruar në certifikatën e pronësisë P-70202016-00964-1, vendi i quajtur “Varosh/Sitniçka” me kulturë “Shtëpi” në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtri.

2. Obligohet Kryetari i Komunës që për paluajshmërinë nga pika paraprake e këtij vendimi si dhe oborrin e shtëpisë të zhvilloj procedurat e shpronësimit konform legjislacionit në fuqi për shpronësim të pronës së paluajtshme. Para fillimit të procedurave të shpronësimit të përgatitet elaborat i detajuar duke përcaktuar sipërfaqen e tërësishme e cila është e nevojshme të shpronësohet.

3. Kryetari i komunës do të ndërmerr masa të nevojshme që të fillohet me përgatitje të projektit për renovim/konservim, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm.

4. Kryetari i komunës do të kujdeset për planifikim të mjeteve buxhetore për vitin 2025, për implementim të këtij vendimi.

5. Objekti “Shtëpi Muze” dhe hapësira ngjitas saj e përcaktuar në projekt dhe aprovuar me këtë vendim, pas përfundimit të procedurave të shpronësimit do të kaloi në pronësi dhe menaxhim të Komunës së Vushtrisë.

53207 NDËRTIMI I RRUG "BEKIMI BERISHA ABEJA"	478,252.00	0.00	478,252.00	0.00
53262 NDËRTIMI I RRUG. "AVNI SARAÇI" VICIANA	58,168.00	0.00	58,168.00	0.00
53278 NDËRTIMI I RRUG. "LUMNI SURDULLI"	425,261.00	39,630.00	385,631.00	9.32
53553 ASFALTIMI I RRUG. NË GOJBULË	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00
53584 ASFALTIMI I RR. SLLAKOC-KURILLOVË -VESEKOVÇ	239,528.00	0.00	239,528.00	0.00
53690 ASFALTIMI I RR. KOLLË	6,638.00	0.00	6,638.00	0.00
54748 REHABILITIMI I RRUGËVE NË DUMNICË, GRACË, LUMMADH, STANOC, MA	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
54750 REHABILITIMI I RRUGËVE NË VERRNICË-SHALÇ, AKRASHTIÇE, BUKOS	45,000.00	0.00	45,000.00	0.00
54754 REHABILITIMI I RRUGËVE NË SMREKONICË, DOBERLLUKË, SLLATINË, P	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00
54788 REHABILITIMI I RRUGËVE NË "DËSHMORËT E KOMNIT" "ARSHIM TAHIRI"	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54775 REHABILITIMI I RRUGËVE NË BIVOLAK, ZHILIVODË, STROG	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54795 NDËRTIMI I "SHESHIT TË LIRISË" NË VUSHTRI	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54798 NDËRTIMI I SHETITORES DHE FUSHËS SPORTIVE TË PALESTRA-VUSH	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00

54788 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË DUNNICË, MAXHUNAJ, STANOC, LUM	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54799 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË GRACË, PRELLIËZHE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54800 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË VERRNICE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54801 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË STUDIME E ULET, CEDELL, SAMADRE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
54808 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BAJNSKË, PASOMË, SLLATINË, BEGA	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54812 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË SHITARICË, PANTINË, HERCEGOVË,	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54814 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BUKOSH, DOLAK, NOVOLAN	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54819 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË DRUAR, MIHALIQ, REZNIK, SHALLC	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54820 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË STROC, BEÇIQ, GLLAVOTIN, BIVOL	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54834 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BEÇIQ, DUBOC	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
55007 RIKONSTRUIMI I BULEVARDIT "ADEMI JASHARI" DHE LIDHJA ME	800,000.00	500,250.30	299,749.70	62.53
55009 NDËRTIMI I RRUG "2 MAJ" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLËSE	80,000.00	0.00	80,000.00	0.00
96018 SHËTITJE NË HISTORI	8,665.71	0.00	8,665.71	0.00
<b>74460 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - VUSHTRI</b>	<b>329,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>329,000.00</b>	<b>0.00</b>
52709 BLERJA E INVENTARIT PËR QKMF-VUSHTRI	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
52719 BLERJA E PAJISJEVE MJEKËSORE QKMF VUSHTRI	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
52778 BLERJA DHE MONTIMI I KLIMAVE PËR OBJEKTE SHËNDETËSORE VUSHTRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54007 TEKNOLOGJI INFORMATIVE PËR QKMF- VUSHTRI	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54013 AUTOMJET TERENI PËR SHKPSH-VUSHTRI	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
54709 RREGULLIMI I SPORTEUT NË QMF- PANTINË DHE QKMF NË OBJEKTIN	7,000.00	0.00	7,000.00	0.00
54707 APARAT PËR HEKUROSIJE ROLE, DHE PAJISJE TJERA	16,000.00	0.00	16,000.00	0.00
54708 KALLDA QILER NË OBJEKTIN E QMF-1 VUSHTRI	77,000.00	0.00	77,000.00	0.00
54709 KOMBI PËR HEMODIALIZË SKPSH-VUSHTRI	39,000.00	0.00	39,000.00	0.00
54710 REHABILITIMI I OBJEKTEVE SHËNDETËSORE DHE RRETHOJAVE PËR QKM	70,000.00	0.00	70,000.00	0.00
54711 INVENTOR PËR LABORATOR PËR QKMF- VUSHTRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
<b>78616 SHËRBIMET SOCIALE - VUSHTRI</b>	<b>10,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>0.00</b>
54950 REHABILITIMI I OBJEKTIT TË QPS- VUSHTRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
<b>78617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRI</b>	<b>15,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,000.00</b>	<b>0.00</b>
54954 REHABILITIMI I OBJEKTIT TË QR - VUSHTRI	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
<b>86024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRI</b>	<b>255,000.02</b>	<b>0.00</b>	<b>255,000.02</b>	<b>0.00</b>
52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETËR" ISH F	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
54727 RREGULLIMI I MEMORIALEVE NË GLLAVOTIN, REZNIK, BEÇIQ, DUBOC,	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00
54731 REHABILITIMI I PLATOSË NË KALANË E QYTIT	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
54735 NDËRTIMIRIKONSTRUIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMMADH,	100,000.00	0.00	100,000.00	0.00
54743 NDËRTIMI I TRIBUNAVE, DHE OBJEKTEVE PËRCJELLËSE NË SADIUMIN	60,000.00	0.00	60,000.00	0.00
92090 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	0.02	0.00	0.02	0.00
92870 ARBIMI PARAFILLOR ÇERDHET - VUSHTRI	60,000.00	0.00	60,000.00	0.00
54885 REHABILITIMI I ÇERDHES „FOLEJA- VUSHTRI	60,000.00	0.00	60,000.00	0.00
<b>93890 ARBIMI FILLOR - VUSHTRI</b>	<b>518,000.00</b>	<b>120,000.00</b>	<b>398,000.00</b>	<b>23.17</b>
52463 RENOVIMI I SHFMU "MIGJENI" STANOC LAGJA ÇAKAJ	13,000.00	0.00	13,000.00	0.00
54749 REHABILITIMI I OBORRIT NË SHKOLLËN SHMU II	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
54755 REHABILITIMI I DHOMAVE TË PARAFILLORËVE VUSHTRI	60,000.00	0.00	60,000.00	0.00
54805 NDËRTIMI I DEPOVE PËR SHKOLLË NË PESTOVE, "RILINDJA", "BAHRI	70,000.00	0.00	70,000.00	0.00

54811 REHABILITIMI I ARKIVES NË SHF ALJ KELMENDI VUSHTERRI	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
54821 REHABILITIMI I SHFMU MUSTAFË SHYTI OSHLAN	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
54890 REHABILITIMI I SHFMU „ENVER HADR“ SHREKONICE	80,000.00	0.00	80,000.00	0.00
55028 NDËRTIMI I SHKOLLËS FILLORE "MUSTAFË VENHAR" VUSHTERRI	200,000.00	120,000.00	80,000.00	60.00
<b>94890 ARBIMI I MEBËM - VUSHTERRI</b>	<b>146,734.05</b>	<b>0.00</b>	<b>146,734.05</b>	<b>0.00</b>
54912 NDËRTIMI I PUNËTORISË PËR AUTOMEKANIK DHE METALPUNUES NË SHM	45,000.00	0.00	45,000.00	0.00
54987 RREGULLIMI I PLATOS BE LAPIDARIT „LUTFI MUSIQI“	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
54972 NDËRTIMI I POLIGONIT NË SHMT LUTFI MUSIQI	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
54978 REHABILITIMI I TUALETEVE NË SHMP BAHRI HAXHA VUSHTERRI	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00
54990 REHABILITIMI I FUSHËS SPORTIVE NË SHMP BAHRI HAXHA	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
54992 NDËRTIMI I KLAGËVE VERORE NË GJIMNAZIN EQREM ÇABEJ VUSHTERRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
93222 RREGULLIMI I SHKOLLËS BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	0.00
95104 FURNIZ.MJETE PER PUNTOR.BALDATOR-AXHUSTATOREVE	157.00	0.00	157.00	0.00
<b>Totali i Përgjithshëm</b>	<b>6,049,888.95</b>	<b>906,663.30</b>	<b>6,043,223.65</b>	<b>13.08</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT



<b>DATE /A:</b>	03.04.2024
<b>REFERENCË :</b>	Nr. 3/4/24
<b>PËR:</b>	KPF-në dhe KK-në
<b>Përmes:</b>	Kryetarin e Komunës Ferit Idrizi
<b>NGA:</b>	Drejtoria për Arsim Drejtore: Alban Tahiraj
<b>TEMA:</b>	Akt përcjellës

Të nderuar,

Bashkangjitur me këtë akt përcjellës gjeni: Draft- Planin nga EPRMB.

Ky akt përcjellës i është nënshtruar diskutimit publik me datën 04.03.2024 ku të pranishëm ishin gjithësej 32 persona me ç'rast u diskutua lidhur me sfidat rreth braktisjes dhe mos regjistrimit në Arsimin e obliguar.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E VUSHTRRISE



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT NË SHKOLLË

2024-26



## **Përmbajtja**

Lista e shkurtesave .....	3
Hyje .....	4
Konteksti.....	6
Qëllimi i planit të veprimt.....	7
Objektivat .....	9
Shtojca.....	19



**Shkurtesat**

---

---

<b>MASHTI-</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>DKA-</b>	Drejtoritë Komunale të Arsimit
<b>SMIA-</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
<b>EPBBM-</b>	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
<b>KN-</b>	Këshilli i nxënësve
<b>KP-</b>	Këshilli i prindërve
<b>KPAK-</b>	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
<b>QPS-</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>OJQ-</b>	Organizatë Jোগeveritare
<b>UNICEF-</b>	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
<b>ECMI-</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
<b>NJKDNJ-</b>	Njësi Komunal për të Drejtat të Njeriut

## HYRJE

---

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkomëtare të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Me që po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente, shtetet orientojnë politikat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ: **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimimit për të gjithë, pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Ligji për mbrojtjen e fëmijës, Rregullorja për Realizimin e të Drejtave Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda etj; bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës

Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj., që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurt, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nenligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes së barabartë në arsim, zbatimin e ligjeve në fuqi. Pastaj, kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim, si dhe dokumentet tjera strategjike ndërsektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim, ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, për të siguruar që të gjithë fëmijët, të jenë përfshirë të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të plotë.

## Konteksti

---

Vushtrria shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe i takon regjionit të Mitrovicës. Sipërfaqja e saj është 345 km<sup>2</sup>, me 66 fshatra, bashkë me qytetin 67 vendbanime. Sipas regjistrimit të vitit 2011, banorë rezident të Vushtrrisë janë rreth 70.000. Në vitin shkollor 2023/24 janë në funksion të arsimit 37 institucione arsimore, prej tyre 3 çerdhe, 3 shkolla fillore, 2 shkolla të mesme të ulëta, 3 shkolla të mesme të larta dhe 26 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta. Gjatë vitit 2023/24 gjithsej numri i nxënësve është 12297. Numri i nxënësve që braktisin shkollën gjatë vitit në klasa 1-9 është 2 nxënës, ndërsa për shkollat 10-12 numri i nxënësve është më i madh deri në 19 nxënës. Numri i nxënësve më vështirësi në të nxënë është 15 nxënës, ndërsa për çdo vit ka rritje. Numri i nxënësve me nevoja të veçanta gjatë vitit 2022/23 ishte 90 nxënës, kurse këtë vit 99 nxënës. Komuna ka themeluar ekipin e EPRMB, ka të themeluar ekipet kundër braktisjes në të gjitha shkollat, ka themeluar ekipet kundër abuzimit të fëmijëve në shkollat 1-9, ka hartuar Planin për siguri në shkolla, si dhe Njësitin Komunal për të Drejtat e Njeriut. Ka në funksion 3 qendra të karrierës, në shkollat e mesme. Të gjitha shkollat në qytet kanë psikologun e shkollave. Çdo vit, shkollat profesionale hapin konkurs për Arsim të rritur. Faktorët që ndikojnë në braktisje: mungesa e kujdesit të prindërve, kushtet e vështira ekonomike, martesat e hershme, problemi me të nxënë, konteksti familjar, largësia në shkolla. Sfidat: funksionimi i ekipeve, krijimi i fondeve, krijimi i qendrave edukative- strehimore, përkatja financiare, kujdesi shëndetësor.

## Qëllimi i planit të punës

Koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor, në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë, duke rinjur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

## Objektivat e Planit Komunal të Veprimt

---

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim.

### Objektivat specifike:

- 1.1 Funkcionalizimi i EPRBMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
  - 1.2 Koordinimi ndërinstitucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
  - 1.3 Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.
- **Objektiva e përgjithshme II:** Ujia e përqindjes së braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë dhe interesat e nxënësve.

### Objektivat specifike:

- 2.1. Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë, duke filluar nga klasa e 6-të;
- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile, sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;
- 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës;

#### 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimt.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitetet, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

#### **Rezultatet kryesore të pretenduara:**

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Funksionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nxënësve të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat, zvogëlimi i braktisjes

#### **Buxheti:**

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 1000 €, pas ndërhyrjeve ka kaluar 1820 €.

#### **Monitorimi:**

Zbatimin e këtij plani e monitorimi EPRBM komunal, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit.

Ky plan veprimt do të shoqërohet me kornizë monitoruese e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjatëmuajtore dhe vjetore, i cili duhet të raportohet në DKA.

**Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBM-ve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim**

**Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune**

Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
1.1.1	Fuqizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi, procesverbalet, Agjendat 2 trajnime	Shtator	Shtator	Shtator	DKA	Komuna MASHTI	Pa Kosto Afërsisht (300 euro)
1.1.2.	Themelimi i EPRBM në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar	Vendimet e EPRBM-ve shkollore	Shator	Shtator	Shtator	DKA	MASHTI Partnerët	Pa kosto
1.1.3	Seanca mbështetëse për EPRBM-në komunale dhe shkollore	Agjendat, listat e pjesëmartjes, procesverbalet, rekomandimet(p.sh. 2 takime dhe 2 trajnime)	Tetor	Tetor	Tetor	DKA	MASHTI Partnerët	OIQ 300 Euro\për vit

1.1.4.	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorime SPH-së	Nr. i takimeve, nr. i shkollave përfutuese	Sipas rasteve	Sipas rasteve	Sipas rasteve	DKA	MASHTI Partnerët	Pa Kosoto ( mund të angazhohet një grup i studentëve =200euro)
--------	--	--	---------------	---------------	---------------	-----	---------------------	--

**Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitutional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë**

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
1.2.1 Takime koordinues me partnerë	Nr. i takimeve, rezultatet	Shator-qershor	Shator-qershor	Shator-qershor	DKA	MASHTI Partnerët	150€për 1 vit
1.2.2 Zhvillimi i projekteve ndërsëktoriale në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt të shkollës të grupeve të caktuara të nxënësve	-3 projekte, aktiviteteve ndërgjegjësuese -Nr. i shkollave përfutuese -Nr. i nxënësve për fitues	Tetor-Mars	Tetor-Mars	Tetor-Mars	DKA	Drejtoritë tjera komunale Partnerët (Drejtoria e shëndetësisë, drejtoria e financave etj.)	150 €për 1 vit <b>OJQ,\BIZNESET LOKALE</b>



1.2.3	Aktivitet ndërgjegjësues për pengimin e angazhimit në punë me qëllim të mbajtjes brenda sistemit arsimorë	Nxënësit e etiketuar në trezik të braktisjes i kemi orientuar drejt mësimit dual me qëllim të nxirjes në procesin mësimor						
-------	--	---	--	--	--	--	--	--

**Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.**

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
1.3.1. Zhvillimi i një sistemi të regjistrimit kumulativ për nxënësit e klasave 6-9	-Regjistri i zhvilluar. -Evidencat	Tetor	Tetor	Tetor	DKA shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
1.3.2. Sigurimi i trajnimeve për mësuesit dhe administratorët e shkollave se si të mirëmbajnë dhe përdorin sistemin e regjistrimit kumulativ;	Trajnimet e zhvilluara	Tetor Mars	Tetor Mars	Tetor Mars	DKA MASHTI	Partnerët	Pa kosto

1.3.3	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe jo akademik të nxënësve	Takimet e realizuara	Sipas rasteve	Sipas rasteve	Sipas rasteve	Sipas rasteve	Shkollat	DKA	Pa kosto
1.3.4	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vëshirësi akademike ose personale;	-Buxheti i ndarë -Aktivitete e realizuara	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	DKA shkollat	MASHTI MEF	-DONATOR Migros 2 100 Euro
1.3.5.	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Pa kosto

dhe çështjet e sjelljes.							
--------------------------	--	--	--	--	--	--	--

**Objektiva e përgjithshme 2. Ujja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.**

**Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të**

Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	-U.A i zbatueshëm -Aktivitet e rregullta, të realizuara -Ndarje e info. - Nga këshilltarët e karrierës (k.k. janë me bazë në shkollë dhe janë lëvizës, ku nuk kemi k.k. caktohen psikologët që janë me bazë në shkollë)	Shtator-gershor	Shtator-gershor	Shtator-gershor	Shkollat DKA	MASHITI Partnerët	DKA Pa kosto

Plani komunal i veprimt kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-26

2.1.2.	Organizimi i panairove të karrierës për t'i ekspozuar nxënëseve para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimi.	-Panairot e realizuara  (p.sh. 2 panairot të organizuara)	Mars	Mars	Mars	Shkollat  DKA	MASHTI  Partnerët	200 euro,  transporti për 1 vit
2.1.3	Angazhimi i këshilltarëve për orientimin në karrierë në shkollat e mesme të ulëta për t'u ofruar nxënëseve këshilla dhe mbështetje profesionale.	-Nr. i këshilltarëve të karrierës të punësuar në shkolla  -2 të propozuar sipas UA				DKA	MASHTI	MEF
2.1.4	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen, i cili përfshin	-Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla  -Java e dyerve të hapura	Nëntor	Nëntor	Nëntor	Shkollat  DKA  Qendra e Orientimit në karrierë në SHMP	MASHTI  Partnerët	3*30=90*3=270  2 persona për hartim të programit. Hartimi i programit 3 ditë për vit.

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti	
		2024	2025	2026				
							Kosto komunale	
	lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.	-Fjalim motivues nga vet nxënësit. e asaj shkolle						
<b>Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës</b>								
2.2.1	Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.	-Materialet e përgatitura -Video materialet	Tetor	Tetor	Tetor	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Donator Migros 100 euro/per 1 vit
2.2.2	Punëtori\sesione me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm	-Nr. i punëtorive, takimeve të realizuara	Tetor	Tetor	Tetor	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Pa kosto

2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre.	-Nr. i seminareve e realizuara me nxënës	x	x	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Pa kosto
2.2.3.	Takime të përbashkëta me prindër, nxënës me folës motivues.	-(2 takime) nr. i takimeve të realizuara	x	x	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	-1 deri 2 takime në vit. -50 € për folës motivues.

**Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.**

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
2.3.1. Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit	Nr. i marrëveshjeve dhe i partnerëve ( afërsisht 30 marrëveshjet i kemi të realizuara)	Shtator -qershor	Shtator -qershor	Shtator -qershor	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Marrëveshje me SHMT dhe SHMP

**Objektiva specifike 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit**

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
2.4.1. Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese	Korniza monitorues e zhvilluar	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
2.4.2. Mbledhja e të dhënave sipas kornizës monitoruese	Të dhënat e mbledhura	Shtator-qershor	Shtator-qershor	Shtator-qershor	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
2.4.3. Analiza e të dhënave dhe raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit	Të dhënat e analizuar	Dhjetor, Qershor	Dhjetor, Qershor	Dhjetor, Qershor	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto

**Shtojca: Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë**

**Ligjet:**

- Kuschetuta e Kosovës,  
<https://gzk.rks-gov.net/ActIDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji 04/L-032 për Arsimin paraimuniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActIDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji nr. 2003/12 për Qasjen në dokumente zyrtare, 6 nëntor 2003, <https://gzk.rks-gov.net/ActIDetail.aspx?ActID=2470>
- Ligji nr. 03/L – 172 për Mbrojtjen e të dhënave personale, 31 Maj 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActIDocumentDetail.aspx?ActID=2676>
- Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 1 Mars 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActIDocumentDetail.aspx?ActID=2440>



### Udhëzimet administrative

- Udhëzimi administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsiminparauniversitar <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalim dhe-kommapu/>
- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 dhjetor 2012, <https://masht.rks-gov.net/9-ua-per-mbledhjen-dhe-raportimin-e-te-dhenave-statistikore-nga-shkollat-dhe-institucionet-parashkollore-ne-arsiminin-parauniversitar-duke-perdorur-sistemin-per-menaxhimin-e-informative-ne/>
- U.A për transferin e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/16-ua-per-kalimin-e-nxenesit-te-shkolles-se-mesme-te-larte-prej-nje-profil-i-arsimor-ne-tjetrin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeter-nr-16-2011-date-30-12-2011/>
- U.A. 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht-nr-08-per-dokumentacionin-shkollor-ne-arsimin-parauniversitar/>
- U.A 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-njohja-e-dokumenteve-te-arsimit-parauniversitar-te-leshuara-jashte-republikes-se-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- U.A. 19/2015, Për sisteminin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sisteminin-e-nxenesve-te-cilet-kanë-migruar-nga-viti-shkollor-2014-2015/>
- U.A. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit e riadhesuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-dt-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kriterëve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mesimit-plotësues-per-nxenesit-e-riadhesuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- U.A 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe->

[planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-afesimin-profesional/](#)

- U.A 02/2014 Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP, resurset, infrastrukturadhe siguria e nxënësve <https://masht.rks.gov.net/ua-masht-nr-02-2014-numri-i-nxenesve-me-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>
- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta <https://ezk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>
- UA- MASHT Nr: 12/2014 Përiqashtimet në moshë me rastein e regjistrimit në arsimin dhe afesimin për të rritur <https://masht.rks.gov.net/ua-masht-nr-12-2014-perqashtimet-ne-moshe-me-rastein-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-afesimin-per-te-riritur/>

(Politika për mësimin dual ka filluar nga shtatori 2022, fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe murator).

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimin, me synimin që në secilën komunë të bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimi për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërliqhen me punën që e bëjnë nxënësit nën moshën 18 vjet.

#### **Strategjitë kombëtare/planet e veprimit**

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026)
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023)
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2022-2026)
- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, në shogërinë kosovare (2022-2026).

**Të tjera:**

- Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)
- Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)
- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Trajtimi i refuzimit të shkollës dhe braktisjeve: doracak i orientuar kah praktika [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual] (tetor 2011)
- Raporti i OSBE-së: Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë <http://www.osce.org/sq/kosovo/95113?download=true> (qasur më 24 mars 2014)
- Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë (MASHT & UNICEF, 2004)
- Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë (MASHT, 2008)
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2014)
- UNICEF, Përmbledhje e Politikave - Të gjithë fëmijët regjistrohen, vijojnë dhe përfundojnë arsimimin, 2014.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

DATA/DATE:	19.03.2024
NGA/OD/FROM:	Zyra për Informim
PËR/ZA/TO:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti për ecurinë e konsultimit të Draft-Planin Komunal të veprimit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17. Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Komisioni për përgatitjen e Draft-Planin Komunal të veprimit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026, ka qenë i përbërë nga:

1. Edona Shotani, kryesuese e komisionit
2. Enver Bajrami, anëtar
3. Ibrahim Lahu, anëtar
4. Nazmije Osmani, anëtare
5. Visar Sadriu, anëtar

Publikimi i njoftimit dhe planit në uebfaqe, platformën e konsultimeve publike, si dhe në rrjetin social facebook të Komunës së Vushtrrisë.

Publikimet:

**Me 14.02.2024**

**Në uebfaqe:**

**Njoftimi:**

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/02/Njoftim-per-konsultim-publik-Draft-Plani-Komunal-i-veprimit-per-Parandalim-dhe-Reagim-ndaj-Braktisjes-dhe-Mosregjistrimit-ne-Arsimin-e-obliguar-ne-Komunen-e-Vushtrrise-2024-2026.pdf>

**Draft-Plani:**

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/02/Draft-Plani-Komunal-i-veprimit-per-Parandalim-dhe-Reagim-ndaj-Braktisjes-dhe-Mosregjistrimit-ne-Arsimin-e-obliguar-ne-Komunen-e-Vushtrrise-2024-2026.pdf>

**Në facebook:**

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=728552939406508&set=a.256978853230588>

**Në platformën e konsultimeve publike:**

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42288>

Lajmi i cili njofton se kur do të mbahet konsultimi publik i publikuar në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/njoftim-per-konsultim-publik-4/>

Me datë 04.03.2024, është mbajtur konsultimi publik, në linkun më poshtë është lajmi për mbajtjen e konsultimit publik i publikuar në uebfaqe dhe në facebook:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/mbahet-konsultimi-publik-per-draft-planin-komunal-te-veprimit-per-parandalim-dhe-reagim-ndaj-braktisjes-dhe-mosregjistrimit-ne-arsimin-e-obliguar-ne-komunen-e-vushtrrise-2024-2026/>

<https://www.facebook.com/KomunaVushtrri/posts/739134918348310>

Me datë 14.03.2024 është publikuar procesverbali nga konsultimi publik:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/03/Procesverbal-Draft-Planin-Komunal-te-veprimit-per-Parandalim-dhe-Reagim-ndaj-Braktisjes-dhe-Mosregjistrimit-ne-Arsimin-e-obliguar-ne-Komunen-e-Vushtrrise-2024-2026SCAN.pdf>

Draft-Plani Komunal i veprimit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026, ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe platformën e konsultimeve publike, nga data 15.02.2024 deri më 15.03.2024.

Tabela me të dhëna nga konsultimi publik:

Metoda e konsultimit	Data	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë për Draft-Planin Komunal të veprimt për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026”	04.03.2024	F M T 18 14 32	6	9

Nr	Kërkesat/Sugjerimet/Komentet	Kush e ka dhënë kërkesën/sugjerimin	Statusi i kërkesës/sugjerimit (pranuar, pjesërisht pranuar apo refuzuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe refuzimin e komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Te shkurtesat faqe 3, mendoj se duhet të jetë NJKDNJ- Njësi Komunal për të Drejta të Njeriut	Remzije Zekolli, zyrtare e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore	Pranohet	Në Draftin final do të shtohet edhe kjo shkurtesë.
	2. Te hyrja, faqe 4, të plotësohet: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës; Rregullorja për Realizimin e të Drejtave Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda;		Pranohet pjesërisht	Sepse Draft-Plani është i bazuar në Konventën për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
	3. Te konteksti, faqe 6 duhet të jetë komuna ka themeluar, e jo formuar, sepse NJDKNJ, komuna nuk harton institucione, por themelon, ndërsa komuna harton Rregullore, Plane etj.		Pranohet	Në Draftin final do të përmirësohet.

2.	1. Në këtë plan të veprimit duhet të përfshihet edhe ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe të ceket roli i njësitit komunal dhe detyrat e tij në këtë Draft - Plan.	Hyrrie Uka, zyrtare për të Drejtat e Fëmijëve	Pranohet	Në Draftin final do të caktohet roli i njësitit komunal dhe detyrat e tij
3.	1. Vështirësitë që po has ekipi për braktisje dhe parandalim në nivel shkolla kur bëhet fjalë për nxënës në rrezik të braktisjes dhe nxënës të evidentuar me mungesa të shumta.	Nasuf Tahiri, drejtor nga SHFMU “28 Nëntori” Vërrnicë	Refuzohet	MASHT-i është i njoftuar për rëndësinë që kanë Trajnimet për zhvillim profesional të mësimitdhënësve rreth çështjes së braktisjes së procesit mësimor nga ana e nxënësve.
4.	1. Tregon për praktikat që ekipi në nivel shkollë ka ndërmarrë për rikthimin e nxënësve në procesin mësimor	Halil Parduzi, drejtor në SHMU 2 Vushtrri	Pranohet	Secila praktikë e suksesshme për rikthimin e nxënësve në procesin mësimor është e rëndësishme sepse shërben si shembull edhe për shkollat e tjera.
5.	1. Është e nevojshme të mbahen trajnime për Ekipin kundër braktisjes në nivel shkollë sepse është esenciale të dihet qartë se si t'u qasen nxënësve në rrezik të braktisjes.	Ardian Jashari, drejtor në SHFMU “Liria” Stroc	Pranohet	MASHT çdo herë planifikon trajnime për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve.
	2. Draft-Plani komunal i Veprimit duhet të jetë në harmoni të plotë me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve		Pranohet	Draft-plani komunal i veprimit është në harmoni të plotë me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve.
6.	1. E përshëndes punën që ka bërë Ekipi komunal për EPRMB dhe po ashtu punën e	Faruk Selimi, drejtor i SHFMU “Martirët” Reznik	Pranohet	MASHT-i është në procedura të hartimit të Sistemit Komulativ për futjen e të dhënave për

T	MASHT-it sepse çdo herë ka nevojë për risi dhe të ketë mundësi për futjen e të dhënave shtesë për nxënësit të cilët janë nxënës potencial të braktisin shkollën.			nxënës të cilat nuk i regjistrojnë ditari.
---	--	--	--	--

Shkurtesat: F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Raporti është përgatitur nga:

Mirjeta Duraku-Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave

Duraku.





**Republika e Kosovës - Komuna e Vushtrrisë**

**Republika Kosova- Opstina Vucitrn**

**Republic of Kosovo- Municipality Vushtrri**

**Drejtoria Komunale e Arsimit**

---

### PROCESVERBAL

Konsultimi publik për Draft-Planin Komunal të veprimit për Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026.

Datë: 04.03.2024

Ora: 11:00

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin: prindër, drejtorët e shkollave të komunës së Vushtrrisë, psikologët e shkollave, përfaqësueset e Njësitit për të drejtat e fëmijëve znj. Hyrie Uka dhe zyrtarja e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore znj. Remzije Zekolli, takimin e shpalli të hapur z. Enver Bajrami i cili edhe e prezantoi draft planin, i cili plan bazohet në pesë shtylla:

1. Braktisja
2. Braktisja e heshtur
3. Parandalimi
4. Mosregjistrimi
5. Rikthimi në procesin mësimor

Tek analiza e gjendjes pati diskutime rreth braktisjes dhe braktisjes së heshtur.

**Remzije Zekolli**, zyrtare e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore tha: të shkurtesat faqe 3, mendoj se duhet të jetë NJKDNJ- Njësi Komunal për të Drejta të Njeriut;

Te hyrja, faqe 4, të plotësohet: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës; Rregullorja për Realizimin e të Drejtave Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda;

Te konteksti, faqe 6 duhet të jetë komuna ka themeluar, e jo formuar, sepse NJDKNJ, komuna nuk harton institucione, por themelon, ndërsa komuna harton Rregullore, Plane etj.

Date: 04-03-2024

Lista e pjesemarrësve për diskutim për Plani për braktisje

Nr rend	Emri dhe mbiemri
1	FIDANE MAXHUNI
2	LEONORA REASNIQI
3	Golip Anahin - GAnahin
4	Manushage Vilda Ruci - Hoxha
5	Sadije Bajgora - Klinaku - SBajgora
6	Arlinda Peta Rexhepi - Telkani
7	Faton Gubetini
8	@ Beom Tomaj
9	Dynerit Elidari
10	Miranda Hoxha
11	Qodaje Luceku
12	Dauline Rencora Saraci
13	ARDIAN SHASHARI
14	Mangime Jashari
15	Njomanza Lahu
16	Bearta Krasniqi Hoxha
17	Vullborna Drajta
18	Mirjeta Maxhuni
19	Lavdim Klimoku
20	Fayz Selimi
21	Halil Panduri
22	Hasuf Tahiri
23	Ferit Arditi
24	Jubim Bireddu
25	Ajzen Uka
26	Ardita Jmezi Azemi
27	Hyrve Uca Hoxha
28	Lomije Jehedi
29	Edona Shotani
30	Emues Bajrami
31	Nazmije Osmani
32	Visar Sadriu



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNITETI KOMUNAL E ARSIMIT  
MUNICIPALITY EDUCATION DIRECTORATE  
OPŠTINSKA UPRAVA PROSFETE

№/M 161/24 Data: 14-02-2024

VUSHTRRI



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

## NJOFTIM

### PËR KONSULTIM PUBLIK

Njoftim për konsultim publik: Draft – Plani Komunal i veprimit për Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.19/2012 i cili përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar komisioni komunal publikon draft planin e lartpërmendur i cili do të dalë në konsultim publik nga data 15.02.2024 deri me datën 15.03.2024. Andaj ju bëjmë thirrje qytetarëve, OJQ-ve, komuniteteve, bizneseve lokale dhe të gjithë të interesuarve të tjerë që gjatë kësaj periudhe kohore ti paraqesin sugjerimet, propozimet apo komentet e tyre në adresat elektronike:

[edonashotani@rks-gov.net](mailto:edonashotani@rks-gov.net) [enver.bajrami@rks-gov.net](mailto:enver.bajrami@rks-gov.net)  
[nazmijeosmani@live.com](mailto:nazmijeosmani@live.com) [visarsad@gamil.com](mailto:visarsad@gamil.com)

Komisioni:

1.Edona Shotani

2.Enver Bajrami

3.Nazmije Osmani

4.Visar Sadriu

